



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 13
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 27 maj 2015, në orën 11:00.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Njomza Emini, Fadil Beka, Besa Baftiu, Time Kadrijaj, Hatim Baxhaku, Shukrije Bytyçi dhe Bekim Haxhiu.

Munguan: Fikrim Damka, Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Të ftuar : Arianit Jakupi, ud. Kryeshef i AKPPM, Ardian Rugova, Arian Ahmeti, Lutfi Mulaku, Dukagjin Zabërgja –AKPPM, Rahman Jasharaj, Ymer Ymeri -SBASHK.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 20.05.2015;
3. Takim me z. Arianit Jakupi, UD. Kryeshef i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale – AKPPM;
4. Takim me Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës - SBASHK;
5. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

Deputetja Besa Baftiu kërkoj që kur te caktohet rendi i ditës , deputetët të njoftohen më herët për të ftuarit , në mënyrë që të përgatiten më mirë për të diskutuar.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 20.05.2015;

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 20.05.2015, pa vërejtje.

3. Takim me z. Arianit Jakupi, UD. Kryeshef i Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale – AKPPM;

Flora Brovina, kryetare – Për këtë mbledhje kemi pasur të ftuar Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, por ai për shkak të agjendës e ka shtyrë takimin prandaj ne e pamë të arsyeshme ta ftojmë UD. Kryeshefin e AKPPM, në një takim për të diskutuar sepse janë aktualizuar disa çështje për licencimin e barnave dhe ka problem edhe me barnat në pjesën veriore të Mitrovicës. Është një takim me interes sa i përket funksionimit të Agjencionit dhe kontrollit të cilësisë së barnave. Ky Agjencion ka marr një nismë të mirë por në kohët e fundit ka disa probleme dhe kemi disa vërejtje edhe nga prodhuesit. Dëshirojmë të informohemi se cila është situata momentale në Agjencionin e barnave?

Arianit Jakupi – Falënderoj për ftesën dhe mundësin që të paraqes para jush punën e Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale. Ju kam sjellur edhe raportin e punës njëvjeçare . AKPPM është e përkushtuar në zbatimin e ligjshmërisë aktuale për shëndetësi në Republikën e Kosovës. Në kuadër të detyrave të veta AKPPM ka për mision mbrojtjen e shëndetit public nëpërmjet garantimit të cilësisë, sigurisë dhe efikasitetit të produkteve medicinale.

Gjatë kësaj periudhe ka pasur ndryshime të mëdha në proceset e punës për shkak të një dinamike të rritur, por edhe për shkak të ndryshimeve cilësore në legjislacion, pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe akteve nënligjore që kanë filluar të aprovohen si detyrim nga ky ligj duke bërë harmonizimin e nevojshëm.

Vlen të theksohet së gjatë këtij viti puna në AKPPM është karakterizuar edhe me një hapje të madhe të bashkëpunimit me shoqatat si atë të farmacistëve dhe distributorëve, dhe tash së fundi edhe me atë të prodhuesve vendor, pastaj me odën e farmacisë si dhe me ekspertë të pavarur të cilët po japin kontributin për zhvillimin e proceseve për të cilat është përgjegjëse Agjencia.

Sa i përket resurseve humane duhet të theksohet se në bazë të Ligjit të ri është aprovuar edhe kostoja buxhetore e cila ka të bëjë me rritjen e stafit për 23 persona të cilët do të shpërndahen në departamente të ndryshme por me prioritet në Laboratorin e Kontrollit të Cilësisë, Departamentit për Narkotik i cili themelohet si department i ri, divizionin e licencimit të pajisjeve medicinale etj. Pra kryesisht në fushat të cilat janë deficitare dhe të cilat është jashtëzakonisht e nevojshme që të zhvillohen më shumë. Por këto vende ende nuk janë aprovuar nga Ministria e Financave.

Kemi filluar testimin e sistemit online për kryerjen e shërbimeve të cilat ofrohen nga AKPPM me ç'rast po thjeshtohet jashtëzakonisht shume puna por edhe po bëhet më transparente, gjithashtu po zvogëlohet edhe më tej koha për evoluimin e dosjeve.

Pas fazës testuese do të fillojmë në mënyrë masovike ta përdorim këtë sistem.

Sa i përket Legjislacionit pas aprovimit të Ligji 04/L-190 për Produkte dhe Paisje Medicinale – Maj 2014, jem në hartim të Projekt Ligji për Narkotik dhe Projekt Ligji për Hulumtime Klinike.

Janë hartuar dhe janë në fuqi Udhëzimet Administrative:

- 01/2014 – tarifat e shërbimeve në AKPPM.
- 02/2014 – Thjeshtimi i procedurave për regjistrimin dhe importin e barnave të peregjistruara.
- 03/2014 – Laboratori për kontrollin e Kualitetit.
- 06-2014 – Lista e produkteve për të cilat nevojitet leja për import.
- 07/2014 – Njohja unilaterale MHRA.
- 01/2015 – Autorizimi për marketing.
- 03/2015 – Laboratorët Galenike.
- 04/2015 – Komisioni për evolucion të produkteve dhe pajisjeve medicinale.
- 05/2015 – Bordi për ankesa.

Janë në pritje për aprovim udhëzimet :

- Praktikat e mira të prodhimit – i dërguar në MSH.
- Praktikat e mira të distribuimit – i dërguar në MSH.
- Për barnatore – i përfunduar.
- Për depo farmaceutike – i përfunduar.
- Për suplemente dietale dhe produkte herbale – i përfunduar.

Deri në shtator pritet të përfundohen udhëzimet për:

- Farmakovigilencë
- Prodhimi dhe regjistrimi i pajisjeve medicinale.
- Reklamimi i produkteve dhe pajisjeve medicinale.
- Importi i produkteve dhe pajisjeve medicinale.

Me këto do të përmbyllem aktet nënligjore të parapara me Ligj.

Bashkëpunimi ndërkombëtar:

- Jemi delegat në EMA
- GMP trajnimet në Poloni
- Bashkëpunimi me BFARM, MHRA, HALMED, CALIMS
- Jemi anëtar në Upsala – për farmakovigilencë
- Në pritje të antarësimit në EDQM- laboratory – (veto nga Serbia)

Regjistrimi i barnave - Autorizimi për marketing:

Kemi eliminuar të gjitha pritjet e rreth 500 lëndëve të cilat kanë qenë në Komision. Sot kur flasim të gjitha lëndët janë brenda procedurave të parapara ligjore.

Kemi arritur që të bëjmë një udhëzim administrativ me të cilin janë të definuara shumë saktë procedurat e regjistrimit të barnave.

Sa i përket licencimit, kemi bërë licencimin dhe rilicencimin e 530 barnatoreve, rreth 130 qarkulluesve me shumicë si dhe 2 prodhuesve medicinal, ndërsa 4 prodhuesve ju ka marr licenca që nuk e kanë plotësuar PMP.

Kemi filluar me licencimin në komunat veriore dhe deri me tani kemi 7 institucione të licencuara, 4 barnatore dhe tri depo. Gjithsej në veri janë 19 institucione farmaceutike të evidentuara. Me marrëveshjen e Brukselit procesi i licencimit është në vazhdimësi. Sa i përket financave kemi pas 26% rritje të të hyrave. Shfrytëzimi i buxhetit ka qenë 99.2 %.

Kemi ber edhe këto Publikime:

- Analiza e produkteve te LE
- Regjistri i barnave 3, ne shtyp numri 4
- Konsumi i barnave në Kosovë

Sa i përket Farmakovigjilencës kemi pas këto raste:

- Rasti Insulin –
- Rasti Gynipral – shkresa dhe vendimi 26/11/2013
- Rasti EMA- kemi pezulluar autorizimet për marketing për një grup produkteve.
- Pilot projekti për informimin e profesionisteve shëndetësor lidhur me farmakovigjilencen.

Sa i përket Laboratorit për kontrollin e cilësisë:

- Është bërë Angazhimi i një specialisteje për ngritjen e cilësisë së punës në laborator dhe përgatitjen për akreditim me ISO standardin për laborator 17025 – kemi aplikuar
- Angazhimi i një eksperti lidhur me funksionalizimin e PCR dhe ELIZA (kontrolli i vaksinave, produkteve te gjakut etj) me metodologjinë më bashkëkohore.
- Angazhimi për kryerje te numrit më të madh të analizave.

Edhe te Banderolat është bërë menaxhimi i suksesshëm i mungesës dhe tejkalimi i problemit te vonesës së shtypjes së tyre, prej një pritje edhe me jave për marrjen e tyre, sot kjo behet brenda ditës.

Kryetarja – Më vije mirë që edhe në Mitrovicën veriore ka filluar licencimi i institucioneve farmaceutike, por ka ende produkte farmaceutike të pa licencuara nga Serbia, që qarkullojnë në barnatoret tona?

Arianit Jakupi – Sa i përket produkteve nga Serbia , në bazë të marrëveshjeve në Bruksel, afati i licencimit është 31 maj 2015. Në bazë të marrëveshjes në Bruksel është arritur konsensus i plot që licencimi i barnave dhe institucioneve farmaceutike të bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi. Afati i cili do të skadojë do të ndaloj importin e pa licencuar të barnave nga Serbia. Mbikëqyrja është kompetencë e inspektoratit farmaceutik.

Kryetarja – Mandatin e kaluar kemi pas disa vërejtje nga Turqia se produktet e BE-së janë të favorizuara për licencim në Kosovë.

Arianit Jakupi – Janë disa lloje te procedurave për regjistrim të produkteve medicinale. Nuk ka pengesë për regjistrim të barnave nga Turqia, por procedura për barna nga BE është procedurë e shkurtuar. Rreth 72 % te barnave ne Kosovë janë nga BE.

Kryetarja – Disa nga pacientët kanë vërejtur se kanë dallim barnat e njëjtë që blihen në një shtet tjetër nga barnat që blihen në Kosovë?

Arianit Jakupi – Opinionet mund të krijohen edhe në mënyrë të gabuar, por ne bëjmë analizat me emër gjenerik për të gjitha llojet e atij produkti dhe garantojmë cilësi.

Besa Baftiu – falënderoi ud. Kryeshefin e AKPPM dhe ekipin e tij për përgjigje në ftesën tonë. Vet fakti se tani dy vite AKPPM nuk ka kryshet por ka ushtrues të detyrës flet për një papërgjegjësi të Ministrisë së Shëndetësisë. U informuam për punën që bëhet në AKPPM por

informatat nga tereni nuk janë ashtu si po thuhet. Jemi dëshmitar se për shkak të procedurave burokratike „ Pliva e Kroacisë” është tërhequr nga tregu i Kosovës, ku ka qenë shkak i tërheqjes ?

Departamenti i farmakovigjilencës është i rëndësishëm por thatë se po ka mungesë të kuadrit, a po mbërrini ti kontrolloni të gjitha barnat që kanë probleme dhe duhet të tërhiqen nga tregu.

Gjithashtu më vjen mirë që ka filluar licencimi i institucioneve farmaceutike në veri dhe barnave nga Serbia, por edhe në regjionin e Gjilanit ka shumë barna pa banderola që vijnë nga Serbia dhe që po qarkullojnë në farmacitë e Gjilanit. Ne duhet që qytetarëve tu kthejmë besimin që barnat po kontrollohen mirë, dhe jo të vrapojnë pas produkteve të pa licencuara, që kinse efekti i tyre është më i mirë.

Arianit Jakupi – Sa i përket „Plivës “ është e vërtetë që „Pliva” është larguar përkohësisht nga tregu, por Pliva tani është blerë nga një kompani botërore dhe është vendim që nga krejt rajoni i Ballkani të tërhiqet. Ne kemi pranuar një shkresë nga Pliva e cila jep edhe një arsye që ka ndikuar në largimin nga Kosovë.

Sa i përket farmakovigjilencës jemi në ngritje të punës në këtë departament.

Rastet e produkteve të tërhequra, ato janë tërhequr nga tregu edhe nga shtete Evropiane, i kemi tërhequr edhe ne.

Ardian Rugova- Sa i përket shkresës së „Plives” është e cekur se për shkak të procedurës burokratike, ata tërhiqen nga Kosova dhe për këtë ne kemi marr masa, sepse kemi pas problem me Komisionin për evaluim të produkteve dhe paisjeve medicinave, sepse i ka vonuar lëndët për shkak të përkthimeve. Me legjislacionin e ri i kemi evituar këto pengesa dhe tani nuk do të ketë më vonesa.

Kryetarja – Tani sa është pritja për regjistrim të një bari?

Ardian Rugova- Tani varësisht nga procedura e aplikimit, të gjitha regjistrimet e barnave kryhen brenda afatit ligjor.

Bekim Haxhiu – Në mbledhjen e fundit që jemi taku ke pas disa dokumente me te cilat ke cek se je duke bërë një punë të mirë. Por tani jam i zhgënjyer me punën e AKPPM, e sidomos jam i zhgënjyer me këtë raport njëvjeçar. Ma herët e dimë se me disa raporte tuaj ka pas edhe arrestime të keqpërdoruesve dhe kontrabanduesve të barnave. Mirëpo për fat të keq dënimet për kontrabandim të barnave kapin vetëm tri vjet dënim, dhe shumica e lëndëve po parashkruhen. Më intereson a po angazhoheni që kontrabanduesit të ndjeken dhe të dënohen , sepse nëse përfundon çështja vetëm me një kallëzim pena, nuk ka sukses.

Gjithashtu është shumë keq që ende je ushtrues detyre dhe nuk i keni kompetencat e plota, dhe gjithashtu keni qen të ndikuar nga ish ministri i shëndetësisë.

Raporti njëvjeçar nuk është fare një raport i pritur, nuk ka asgjë përmbajtjesore disa faqe janë organogram , disa faqe tjetër janë fotografi të objektit, dhe duke pasur parasysh begrandin tënd , nuk e kam prit një raport të tillë.

Nivel i kontrabandimit dhe falsifikimit të barnave është në nivel të madh. Qytetarët e kanë humbur besimin në barna që tregtohen në Kosovë.

Në Kosovë kemi dy prodhues të licencuar, njërit prej tyre nuk i pranohet tregtimi në Shqipëri, çka presim ne kur as Shqipëria nuk na beson për kualitetin e barnave.

Edhe kontrabandimi i barnave është i madh dhe filloj një fushat e ndjekjes së barnave dhe pajisjeve të kontrabanduara, kryeinspektori Basri Rexha ishte duke e udhëhequr këtë aksion por derisa i preku disa biznesmen të madhej të kontrabandimit, ju e suspenduat. Dëshiroj të na

tregosh arsyen e vërtet të suspendimit të inspektorit farmaceutik z. Basri Rexha? Cilët biznesmen kontrabandës i ndëshkoj, dhe me sugjerime të kujt e suspendove ?

Në legjislaturën e kaluar u miratuar Ligji për produkte dhe pajisje medicinale dhe ligji ka kaluar me disa nene kunderthënese dhe ka disa përzierje të kompetencave, por ju këshilloj që bashkë me Ministrin e Shëndetësisë të punoni në inspektimin e këtyre barnave të kontrabanduara. Derisa njerëz prej biznesit të ndërtimtarisë futen në tregun e barnave, e shohin si fitimprurës kontrabandimin e barnave.

Ndoshta edhe vet funksionimi si ushtrues detyre ju ka pamundësuar ushtrimin në mënyr profesionale të funksionit tuaj.

Kryetarja – Kur ju i licenconi prodhuesit vendor, cili është problemi që ata nuk po mund të veprojnë jashtë Kosove?

Arianit Jakupi – Sipas agjendës jam ftuar në Komision vetëm për Licencim të produkteve medicinale, e nuk ka qenë temë diskutimi raporti i punës, këtë e kam sjell vetëm për njoftimin tuaj.

Sa i përket mbylljes së laboratorëve dhe prodhuesve kemi të mbyllur fabrikën e barnave në veri „Mediafarm “ kemi të mbyllur fabrikën „Farmakos” kemi të mbyllur fabrikën „Lindi Grup” dhe fabrika „Primafarm “ është e licencuar vetëm për paketim sekondar.

Nuk besoj se ka neglizhencë nga AKPPM për këto raste. Sa i përket kontrabandimit unë nuk kam kompetencë sepse nga muaji maj i vitit të kaluar inspektorati farmaceutik është pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë. Sa i përket rastit „Tre farmë “ është prodhues i licencuar me rreth 70 produkte të licencuara. Sa i përket regjistrimit të këtij prodhuesi në vendet tjera nuk kam kompetenca në këtë çështje.

Sa i përket rastit të z. Basri Rexha , shpjegime për këtë rast janë dhënë shumë herë nga ministri në Kuvend. Nëse shikohet dosja ai ishte dashur të largohet krejtësisht nga puna sepse nuk mundet një person të terrorizoj krejt kolektivin. Komisioni disiplinor ka vendosur në bazë të dosjes dhe rregullave të komisionit disiplinor. Tani është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë ta gjej pozicionin për këtë person, ndërsa arsyet e suspendimit mund të ju dërgoi me shkrim.

Bekim Haxhiu – Edhe ju po e pranoni se „Tre Farmit” nuk i është lejuar të tregtoj në Shqipëri dhe kjo tregon që këtij kualiteti të barnave që prodhohen në Kosovë nuk i beson as Shqipëria.

Ne po i përdorim ato barna që në Shqipëri nuk pranohet të tregtohen.

Ju thatë se z. Rexha ka terrorizuar punëtorët , por ne kemi par z. Rexha që ka qenë i guximshëm ti ndëshkoj kontrabanduesit më të fuqishëm të barnave, deri te kryetari i shoqatës farmaceutike, dhe në momentin që e ka ndëshkuar kryetarin e shoqatës, ju keni ftuar disa punëtor të bëjnë deklaratat dhe e keni larguar nga puna në emër të asaj që ka terrorizuar punëtorët. Keni bërë mirë se tani punëtorët janë të qetë por edhe kontrabandistët janë të qetë , keni krijuar një paqe që nuk e kam prit nga ju.

Në legjislaturën e kaluar kemi biseduar për një raport i cili e paraqet gjendjen në të cilën kanë prodhuar dhe pakeluar dy kompanitë „Farmedi” dhe „Primasfarm” dhe që ju i keni mbyllur për shkak të prodhimit ilegal, dhe pa kushte të parapara me Ligj . Tani thoni që „Primafamin” e keni licencuar të punoj legalisht, një kompania e ndëshkuar për punë ilegale.

Arianit Jakupi – Më vije keq që nuk jeni i informuar në mënyrë të duhur sepse AKPPM nuk ka marr deklaratat nga punëtorët gjatë kohës së suspendimit të inspektorit Rexha , por suspendimi rrjedh nga problemet që ky inspektor i ka pasur gjatë tërë kohës sa është i punësuar në AKPPM. Rastet për të cilët ju flisni rasti „Lekamed” ai është i mbyllur dhe nuk i kemi dhënë licencë, ndërsa sa i përket „Primafarm “, pas investimeve që ka bërë dhe një inspektimi ndërkombëtar i është dhënë leja vetëm për paketim.

Sa i përket inspektimeve që z. Rexha i ka bërë, të gjitha kanë qenë me urdhrin tim , unë kam qenë në ballë të proceseve. Por kur ka filluar ti shkel procedurat dhe duke marr parasysh edhe rastet e më hershme e kam suspenduar . Unë nuk e kam pas në rend dite këtë çështje dhe jam i gatshëm të ju përcjell dosjen e këtij personi.

Bekim Haxhiu - A është ngrit kallëzim penal kundër „Primafarmit “

Arianit Jakupi – Rasti i „Primafarm “ është në prokurori, Bordi për ankesa në koordinim me prokurorin kanë shkëmbyer informacione dhe në bazë të asaj është proceduar çështja.

Bekim Haxhiu – Një kompani e ndëshkuar për falsifikim është licencuar për paketim .

Arianit Jakupi – Unë kam zbatuar ligjshmërinë e cila vjen nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Njomza Emini – Keni qenë pjesë e delegacionit për bisedime më Serbin ku temë ka qen njohja e certifikatave të produkteve medicinave dhe çështja e licencimit të kompanive në veri që merren me importe të barnave. Do ishte mirë të na informoni se çka do të përfitojnë qytetarët tonë nga këto marrëveshje?

Çështje tjetër është çështja se disa mjek e bëjnë përshkrimin e barit në bazë të emrit të fabrikës e jo në emër gjenerik, dhe po ka marketing për disa kompani , a keni informata për këtë çështje?

Dua ta ngris edhe çështjen e fletëudhëzimit të barnave që te shumica e barnave nuk është në gjuhen shqipe.

Arianit Jakupi – Që nga bisedimet në Bruksel, kemi filluar licencimin e institucioneve që merren me tregtim të barnave në veri. Sa i përket bisedimeve jemi në fazën përfundimtare të bisedimeve por ende nuk ka marrëveshje , nuk mund të flas më shumë por në parim jemi pajtuar që licencimi do të bëhet konform legjislacionit në fuqi në Kosovë. Qytetarët do të fitojnë se do të kenë barna të licencuara dhe importi i tyre do jetë i rregullt dhe i kontrolluar.

Sa i përket emrit gjenerik të barnave kjo është e rregulluar me ligjin e shëndetësisë dhe është kompetencë e inspektoratit shëndetësor. Gjithashtu edhe çështja e fletudhëtimeve është çështje e inspektoratit farmaceutik.

Hatim Baxhaku – Lidhur me përshkrimin e barnave sipas emrit gjenerik është e paraparë me ligj, por u përmend se ka dyshime në kualitetin e barnave si nga mjekët ashtu edhe nga pacjentët, si është e mundur që ti ndalohet mjekut ta përshkruaj një bar me emër të fabrikës , por ti lejohet farmacistit që ta ndërroj barin si të dëshiroj dhe ta favorizoj ndonjë kompani prodhuese. Është edhe më i rëndë keqpërdorimi kur farmacistit i lehet mundësia që ta ndërroj barin.

Time Kadrijaj – Sektori farmaceutik është një sektor i përfolur mjaft, dhe mjaft i rëndësishëm, po më intereson pse tash një kohë të gjatë AKPPM- ja është me ushtrues të detyrës së kryeshefit, pse nuk është zgjedhur kryeshefi?

Çështje tjetër është çështja e Ligjit për produkte dhe pajisje medicinave i cili ka kaluar në Kuvendin e Kosovës, por për shkak të disa mospajtimeve në mes grupeve parlamentare nuk kanë kaluar amendamente e Komisionit dhe Ligji ka mospërputhje të neneve, a keni pengesa në zbatim të këtij Ligji?

Arianit Jakupi – Sa i përket pozitës së kryeshefit, tetorin e vitit të kaluar është shpallur konkursi i cili për arsye administrative është anuluar, megjithëse nuk ka ndonjë shkresë zyrtare, pritet që gjatë ditëve në vijim të rishpallet konkursi.

Sa i përket Ligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale në shumicën e neneve është në rregull, por në raste të caktuara ka kundërtënie në mes neneve, prandaj disa nene duhet të ndryshohen.

Flora Brovina – A jeni pjesë e marrëveshjes bilaterale në mes të Kosovës e Shqipërisë sa i përket fushës farmaceutike?

Arianit Jakupi – Jo nuk jemi pjesë e kësaj marrëveshje.

Shukrije Bytyçi – E vlerësojmë punën e z. Jakupi, është shqetësuese situata që ende AKPPM udhëhiqet me ushtrues detyre.

A është i gatshëm laborator i kuadër të AKPPM, të testoj të gjitha barnat që janë në qarkullim në Kosovë.

A mendoni se të gjithë inspektorët farmaceutik janë profesionist, dhe a mendoni se këta jo profesionistë janë shkaktarë të mos funksionimit të këtij sistemi.

Arianit Jakupi – Ne i bëjmë analizat e barnave nga tregu dhe tani kemi filluar me përdorimin edhe të dy aparatave që janë Eliza dhe PSIR, me këtë synojmë që të gjitha barnat që qarkullojnë në Kosovë të bëhet analiza. Ne shpresojmë që me rritjen e numrit të punëtorëve të bëjmë dyfishimin e numrit të analizave.

Sa i përket inspektoratit nuk është kompetencë e AKPPM së.

Fadil Beka – Në raportin e punës Organogrami ishte i vitit 2005, dhe ju kishit propozuar organogram të ri, pse nuk është aprovuar?

Arianit Jakupi – Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës në AKPPM, është dërguar për miratim në Ministrinë e Shëndetësisë, por vakumi institucional ka bërë që të vonohet aprovimi, shumë shpejt presim që kjo rregullore do të aprovohet.

Flora Brovina – Ju falënderoj për pjesëmarrje dhe për kontributin tuaj dhe ju paralajmëroj se shumë shpejt do ta vizitojmë AKPPM në.

4. Takim me Sindikatën e Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës - SBASHK;

Kryetarja – Mirëserdhët, jemi takuar edhe në kuadër të takimeve që kemi pas me Këshillin Trepalësh, me sindikalistët, tani ku ndodhi me kërkesat e juaja, çfarë janë problemet e juaja momentale të sindikatës dhe prezantimi i këtyre problemeve në këshillin trepalësh. Ju e dini që e kemi monitoruar ligjin, i keni dhënë vërejtjet e juaja, dhe kemi pas disa kërkesa nga sindikata e arsimit, ju lutem ti prezantoni kërkesat tuaja.

Rrahman Jasharaj- Me lejen tuaj fillimisht ju përshëndes të zgjedhurit e popullit.

Është hera e dytë që jemi mes jush, që po bisedojmë me të zgjedhurit e popullit, problemet që po ngrit SBASHKU janë kryesisht qëllim mira, që ligjet të jenë të rregullta dhe ti përshtaten realitetit në Kosovë. Edhe Ligji për Këshillin Ekonomiko-Social është ligj që si i tillë dëmton pikërisht sindikatat që janë reale dhe të forta dhe i mundëson të vetmes sindikatë që është amorfe dhe që nuk ka anëtarësi që të jetë pjesë e dialogut. Po e shihni edhe ju si po bëhen atje punët, pastaj po kemi telashe me grevat, pikërisht ndodhe kjo se SBASHKU nuk është aty ku e

meriton, për ne është e çuditshme nëse ministria e arsimit është pjesë e Këshillit Ekonomiko-Social, duhet të krijohen amendamente të këtij ligji, që ti mundësohet që SBASHKU të jetë pjesë e këtij këshilli, ku do të bënte dialog të drejtpërdrejtë me partnerin social, me MASHT-in, kjo do të vlente edhe për ministrinë e shëndetësisë . Le të jetë edhe sindikata e shëndetësisë, të gjithë ministritë që janë gjithsej pesë, le ti kenë në KES partnerët social sepse KES-i do të ishte arena po them në mënyrë figurative ku do të zhvillohej dialogu dhe unë besoj pastaj do të arriheshin marrëveshje dhe nuk do të kishte fare nevojë për grevë. Atë letërën që ju kemi drejtuar juve deputet të nderuar edhe juve kryetare e nderuar që të angazhoheni po ua përcjell lutjen e mijëra mësimdhënësve anëtarë të SBASHKU-t, që ta ngritni zërin bashkërisht sepse ju nga të gjitha subjektet pjesëmarrëse në Parlament, që të shikohet Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti. Neni 8 është amendimetuar fal jush, fal anagazhimit tuaj pika 6 e tregon qartë së mësimdhënësit e Kosovës po them mësimdhënësit shqiptarë, u takon pensioni i punës sepse neni 8 pika 6 thotë se janë njohur si vite kontributdhënëse. Të ju them të vërtetën po flas mes jush qartë dhe po e përcjelli mesazhin e tyre, mësimdhënësit nga hutia nga interpretimet e gabuara, ne kemi kontakte të vazhdueshme po e shtrojnë pyetjen si është e mundur që shteti ynë për të cilën ata kanë dhënë kontributin modest në vitet më të vështira, pikërisht në vitet në të cilat jemi dëshmuar se punojmë me sistemin e Republikës së Kosovës, pikërisht ato vite, ende janë në lajthitje, ende nuk njihen, pjesa dërmuese e mësimdhënësve dalin në pension me 75 euro, me pensionin e pleqërisë, e jo me pensionin e tanishëm 140 euro. Prandaj ju lus edhe njëherë në emër të gjithë të punësuarve në arsim që ky ligj që është dekretuar nga presidentja Jahjaga të zbatohet në mënyrë që nëpër komuna mësimdhënësit, pas gjithë atyre viteve, pas një pleqërie të lodhshme, mos të shkojnë nga zyra në zyrë dhe mos të ju thonë se nuk ju takon pensioni i punës. Ne nuk po kërkojmë që të rritet ky pension për arsimtar, por pensioni i punës le të vlejë edhe për mësimdhënësit tonë që pjesa dërmuese e tyre e kanë dëshmuar vetën, për ndonjë element tjetër konkret për këtë ligj e lus kolegun tim Ymerin, nëse ka diçka të shtoj, prapë po them faleminderit që keni gjet kohë të na pritni, ne jemi të gatshëm të vijmë edhe herëve të tjera.

Kryetarja- Faleminderit !

Ymer Ymeri- Nuk kam diçka të veçantë, ndoshta një plotësim të vogël të Ligji për Këshillin Ekonomiko- Social, kështu si tha edhe kryetari edhe ne mendojmë me qenë në përbërje të Këshillit Ekonomiko- Social ndoshta duhet me u rishqyrtuar ai ligj për shkak se është në përbërje Qeveria, Oda Ekonomike dhe Aleaca Kosovare e Biznesit dhe sindikatat. Në një formë Qeveria Oda Ekonomike dhe Alanca e Biznesit janë punëdhënës që mbrojnë firmat e jo punëtorët dhe sindikatat janë të mbivotuar çdo herë në përbërjen e këtij këshilli, sepse është bilanci 10 me 5, dmth 5 që përfaqësojnë punëtorët dhe 10 që përfaqësojnë punëdhënësit. Ndoshta është dashtë me u shikuar përbërja, edhe në përbërje ashtu siç shkruan që nga qeveria merr pjesë ministri i arsimit, i shëndetësisë, i punës dhe ministrat e tjerë, ndoshta me qenë përbërja adekuate e përfaqësuesve të punëtorëve në këtë këshillë. Dëshiroj të kërkoj nga ky komision që të monitoroj ligjin për skema pensionale kontributdhënëse, edhe pse ky ligj është martuar nga Kuvendi në përbërjen e kaluar është dekretuar nga presidentja Jahjaga, me datën 21 maj 2014, neni 8 paragrafi 6 i këtij ligji nuk zbatohet. Të gjithë ata mësimdhënës dhe punëtorë të arsimit të cilin ky ligj e specifikon se ju njihet përvoja e punës prej vitit 1990 deri 1999, nuk zbatohet ndoshta në mungesë të ndonjë udhëzimi administrativë që ministria e punës nuk e ka nxjerr. Andaj ju si komision më i dhënë rëndësi pak më të madhe zbatimit dhe ta diskutoni me ministrinë e punës, pasi është aprovuar nga Kuvendi, faleminderit për ftesën.

Kryetarja- Faleminderit, ne realisht kemi caktuar takim me Ministrin për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe do të flasim për pensione, prandaj ishte i mirëpritur ky takim me juve, paraparakishtë të përgatitemi edhe për pyetjet që do t'ia shtojmë ministrit.

Shukrije Bytyci- Faleminderit kryetare, përshëndetje për përfaqësuesit e sindikatës së arsimit. Ne si deputet e kemi ngritë çështjen e pensionimit të këtyre mësimdhënësve në seancën e fundit, unë e kam ngritë këtë çështje, vërtet mësimdhënësit e viteve të 90-ta kanë bërë një punë shumë të çmueshme, më gjithë atë presion, me gjithë ato vështirësi, dhe pa asnjë kompensim. Është i vonuar ky Ligj, ne do të kërkojmë nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale që do ta kemi së shpejti në takim, ta marr ndonjë hap të paktën sa më shpejtë të filloj, ndoshta nuk është ndonjë shumë e madhe, por ajo që ti bëhet një respekt për atë kontribut, për ato vite është shumë domethënëse. Ne e dimë që shumë mësimdhënës janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe shëndetësore, andaj ne do ta japim kontributin tonë të vazhdueshëm edhe në takim me ministrin. Te përfshirja e sindikatës së arsimit në KES, mendoj që duhet të punohet në atë drejtim, ne do ti marrim vërejtjet e juaja dhe ministria e arsimit është pjesë, edhe sindikata e ndihmojnë dialogun social.

Time Kadrijaj – Faleminderit kryetare, ju përshëndes juve përfaqësues të sindikatës së arsimit. I kemi ndjek me vëmendje shqetësimet e juaja dhe grevat, kemi bashkëndjerë, meqenëse ato janë kërkesa të juaja janë kërkesa legjitime, që qeveria dhe institucionet përkatëse e kanë obligim ti zbatojnë.

Ne duke ditë edhe kontributin e mësimdhënësve dhe të personelit shëndetësorë, që në ato ditë të vështira kanë punuar, është mëkat i madh për njerëzit që janë sakrifikuar në ato periudha të ndritshme kur është dashtë të punojmë paralelisht në një sistem paralel, ne gjithë anëtarët e komisionit kemi qenë dakord që të përfshihen jo me i bë nder dikujt por sepse e kanë merituar. Ato gjenerata me atë sakrificë, kanë mundur edhe këta mjekët, profesorët dhe arsimtarët me ik jashtë shtetit, në përfundim, mirëpo ajo ndjenja patriotike dhe kombëtare i ka ndal që të vazhdojnë punën në një sistem paralel që vërtet ka kontribuar në kontinuitetin e punës.

Normal ligjet që aprovohen në Kuvend janë ligje që obligojnë Qeverinë dhe ministrinë përkatëse me i respektuar. Ndonjëherë për shkaqe buxhetore po prolongohet implemetimi i këtyre ligjeve, megjithatë ligji është obligativ dhe obligon Qeverinë dhe ministrinë me i njohtë përvojën e punës. Në nuk do të ndalemi, nuk do të ndalemi as me takime me ju, ne do të kërkojmë hiq më shumë se sa veç me u respektuar ligji.

Besa Baftiu – Faleminderit kryetare, përshëndetje për sindikatën e arsimit. E dimë që problemet janë shumë të mëdha në arsim, por dy problemet më të mëdha që ju cekët, janë mos përfaqësimi i juaj në Këshillin Ekonomiko -Social, të cilën e kemi has edhe gjatë monitorimit të këtij ligjit, i kemi dërguar rekomandimet në Qeveri, mirëpo ajo që është shqetësuese është mos përfaqësimi i juaj i cili me ligj është sanksionuar.

Do të punojmë që ju të bëheni pjesë e KES.

Sa i përket Ligjit për Skemat Pensionale, shumë Ligje miratohen por nuk zbatohen. Nëse një Ligj nuk zbatohet, nuk duhet as të miratohet. Përvoja ju takon me Ligj dhe patjetër duhet të ju bëhet pagesa, sidomos këtyre njerëzve që kanë kontribuar në periudhën më të ndritshme.

Desha të ju pyes se a është duke ju paguar përvoja e punës 0.5 sepse kam informata se kjo po zbatohet në mënyra të ndryshme, dhe cila po merret si pagë bazë?

Kryetarja – Sa i përket KES, ai është këshill trepalësh e jo dy palësh, të gjithë janë të barabartë.

Ymer Ymeri- Ndoshta gjatë amendamentimit të Ligjit për KES, do të ishte mirë që të gjendet një formulë që përfaqësimi të jetë i barabartë, sa punëdhënës sa të punësuar.

Sa i përket të punësuarve në arsim nga 28000 sa janë, në sindikatën SBASHK janë të anëtarësuar 25 675, pra mbi 70 % të punësuarve.

Sa i përket 0.5 % ka filluar të zbatohet në muajin prill, por ka pas shumë gabime, por kemi premtime se do të përmirësohen këto gabime. Paga bazë është 405 euro.

Fadil Beka – Ju përshëndes dhe e përcjellim aktivitetin tuaj sindikal , dhe presionin sindikal mos e ndalni, por të kihet kujdes me grevat se po pësojnë nxënësit. Ne ju mbështesim në aktivitetet tuaja.

Kryetarja – Ju falënderoj për pjesëmarrje dhe ne do të insistojmë të kuptojmë nga ministri se kur do të filloj zbatimi i nenit 8 të Ligjit për Skemat Sociale të financuara nga shteti.

5. Të ndryshme.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që pas dy javësh në mbështetje të KDI të mbahet dëgjim publik për Projektligjin për Shërbimin Mjekësor Emergjent.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA